



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



DOSJA E TENDERIT

Sipas nenit 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085) dhe Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit për

“Zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit”

PROCEDURA ME OFERTË TË HAPUR

Data e publikimit të Dosjes së Tenderit:

2 maj 2017

Titulli: ***Zgjedhja e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit***

KJO DOSJE E TENDERIT PËRBËHET NGA DY PJESË:

Pjesa A: Procedurat e tenderimit që përmbajnë instruksione se si të përgatiten tenderët;

Pjesa B: Forma e tenderit, d.m.th. dokumentet që duhet të dorëzohen nga tenderuesit.

Kjo dosje e tenderit është përgatitur në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



LËNDA: FTESA PËR TENDER për Zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

Ju faleminderit për interesimin tuaj për pjesëmarrje në aktivitetin e lartpërmendur.

Në përgjigje të kërkesës suaj, ju lutem gjeni të bashkangjitura dokumentet, që përbëjnë Dosjen e Tenderit.

Nga ju pritët të shqyrtoni me kujdes të gjitha pjesët dhe seksionet e kësaj dosjeje tenderi dhe shtojcave të saj për të qenë në pajtim me të gjitha kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përfshira këtu.

ZRRE nuk do të pranojë asnjë përjashtim nga kushtet dhe specifikat e përfshira në këtë dosje tenderi.

Nëse dështoni të dorëzoni një tender në ZRRE brenda afatit të specifikuar në këtë dosje tenderi dhe/apo që nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e vendosura në këtë dosje, i njëjti do të refuzohet dhe do të konsiderohet si *"tender i papërgjegjshëm"*.

Shpenzimet për përgatitjen dhe dorëzimin e tenderit nuk do të rimbursohen dhe asnjë borxh i juaji nuk do të merret parasysh nga ZRRE në rast të anulimit të procedurës.

Procedura e këtij tenderi rregullohet në pajtim me nenin 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085.

Rregulla e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit mund të shkarkohet nga uebfaqja e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE): www.ero-ks.org.

Tenderët duhet të dorëzohen në adresën e specifikuar në pjesën A "Procedurat e Tenderimit", deri me datën 31 maj 2017.

Me dorëzimin e një tenderi, tenderuesi pranon në tërësi dhe pa asnjë kufizim kushtet e paraqitura në këtë Dosje të Tenderit, që rregullojnë këtë shërbim të propozuar si baza e vetme e kësaj procedure të tenderimit.

Ne presim të pranojmë tenderin tuaj,

Nëse ju vendosni të mos dorëzoni tender, do të ishim mirënjohës nëse do të na informoni me shkrim, duke deklaruar arsyet për vendimin e juaj.

I juaji sinqerisht,

Krenar Bujupi, u.d. Kryesues i Bordit të ZRRE-së

DOSJA E TENDERIT – ZGJEDHJA E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA A: PROCEDURAT E TENDERIMIT.....	4
SEKSIONI I. INFORMATAT PËR TENDERUESIT.....	4
TË PËRGJITHSHME.....	4
KUSHTET QË DUHET PLOTËSUAR NGA TË LICENCUARIT PËR FURNIZIM.....	5
PËRMBAJTJA E DOSJES SË TENDERIT	8
PËRGATITJA E TENDERËVE.....	9
DORËZIMI DHE HAPJA E TENDERËVE	10
VLERËSIMI DHE KRAHASIMI I TENDERËVE	12
DHËNIA E KONTRATËS	12
SEKSIONI II. ANEKSET INFORMATIVE PËR TENDERUESIT	13
ANEKSI 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE OBLIGATIVE	13
ANEKSI 2. DEKLARATA NËN BETIM	14
ANEKSI 3. KËRKESA PËR KONFIDENCIALITET	15
ANEKSI 4. KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË.....	16
ANEKSI 5. KRITERI PËR DHËNIE	17
ANEKSI 6. MODELI I GARANCIONIT PËR PERFORMANCË	18
PJESA B: FORMULARI I DORËZIMIT TË TENDERIT.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
SEKSIONI I. FORMULARI I TENDERIT	19
SEKSIONI II. OFERTA FINANCIARE.....	21

DOSJA E TENDERIT – ZGJEDHJA E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT

